



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 18 datë 20.7.2023**

PËR

MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/PËRDORIM, TË SIPERFAQES 0.3201ha NË EKONOMIN PYJORE “PRUEMOS SHELDI”, NGA STRA 104, NJ.A GURI ZI, FSHATI SHELDI, PËR AKTIVITETIN INSTALIM TË SHTYLLËS ERËMATESE PËR STUDIMIN E ERËS, AEROGJENERATORË, PËR NJË PERIUDH 12 MUAJ për shoqërinë “ Voltalia Albanie”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 20.7.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja ‘e/1’ ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 115/2014 date 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverijes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM 559 datë 29.07.2022 për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, i ndryshuar VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronesi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar; Udhëzimin e Ministritte Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave,

V E N D O S I:

1. Të miratojë, dhënien me qira/përdorim, të siperfaqes 0.3201ha në ekonominë pyjore “Pruemos Sheldi”, ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “**Voltalia Albanie**”, të detajuar si më poshtë:

Tabel përmbledhëse dhënie në përdorim/qira E.P PrueMos Sheldi, ngastra 104

	Vlera e përdorimit të rrugës /km	Vlera e përdorimit lek/ha/vit	vlera totale
sip/ ha/km	1 km	0.3201ha	93 898.4 (Nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjet e tetë pikë katër) lekë
lek/vit/ha/km	35 000 lekë/vit	184 000 lek/ha/vit	
afati kohor	1 vite	1 vite	
totali	35 000 lekë/vit	58 898.4 lekë vit	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LUKI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 10

Zbardhur me datë 21.7.2023